



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE VLORE

Nr.2106/199 Akti
Dt.regj.09.12.2014

Nr 192Vendimi
Date 13.02.2015

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

Sot me date 13.02.2015 Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore e perbere nga gjyqtari **KEN DHIMA**, asistuar nga sekretaria gjyqesore Kamila Petriti, shqyrtoi ne seance gjyqesore me dyer te hapura ceshtjen civile me **nr 2106/199 akti** date 09.12.2014 qe i perket:

PADITES:

Sherbet Arapi, i biri i Sul me datelindje 11.02.1961, lindur dhe banues ne Cerme Ciflik, Komuna Terbuf, Lushnje perfaqesuar nga Av Erjon Sina.

I PADITUR


- 1-Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier, Lagja Apollonia rruga Brigata 11 Sulmuese", Fier, ne mungese.
- 2- Drejtoria Apelimit Tatimor, Tirane, ne mungese.

OBJEKTI:

- Anullimi/shfuqizim i njoftim vlersimi per Detyrimet tatimore nr 12213 prot date 20/08/2014 te nxjerre nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier.
- Anullimin/shfuqizimin i vendimin nr 24141/1 date 11/11/2014 i Drejtorise se Apelimit Tatimore prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane.

BAZA LIGJORE:

Nenet 32/a, 324/a i K.Pr.Civile; neni 118/1 i K.Pr. Administrative, neni 109/2, 123/c I Ligjit nr. 9920, date 19/05/2008 "Per procedurat tatimore ne RSH" I ndryshuar, Udhezimi Nr.24, date 02/09/2008 "Per procedurat tatimore ne RSH".



Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te zhvilluar me dyer te hapura gjykata pasi degjoi paditesin i cili kërkoj pranimin e padise sipas objektit dhe te paditurit i cili kërkoj rrezimin e padise dhe pasi shqyrtoi provat e administruara ne dosje dhe bisedoi ceshtjen ne teresi, si perfundim,

VEREN

Se para Gjykates Administrative te Shkalles se pare Vlore paditësi Sherbet Arapi ka paraqitur nje padi me objekt si me siper.

Gjykata cmon se ka juridiksion per gjykimin e kësaj ceshtjeje pasi kunder per ceshtjen ne gjykim nuk parashikohet ne aktet ligjore e nenligjore ne fuqi ankim ne nje organ me te larte por drejtpersedrejti ne gjykate.

Gjykata cmon se kjo padi eshte ne kompetencen funksionale te kësaj gjykate konform nenit 10 te Ligjit Nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative".

Gjykata cmon se eshte ne kompetencen lendore te kësaj gjykate shqyrtimi i kësaj ceshtjeje pasi padia eshte nje prej atyre te parashikuara ne nenin 7 pika "ç" te Ligjit Nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative".

Gjithashtu gjykata cmon se eshte ne kompetencen tokesore te kësaj gjykate shqyrtimi i kësaj ceshtjeje pasi sipas nenit 11 pika 2 te Ligjit Nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative": Ne rastin konkret e paditur eshte Drejtoria Rajonale Tatimore Fier dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane.

Nga provat e administruara ne seance gjyqesore ka rezultuar se pala paditese Sherbet Arapi eshte regjistruar prane QKR ne daten 01.01.2003 me nr Nipt K34223403G si Person Fizik dhe ushtron aktivitetin e tregetimit te artikujve te ndryshem.

Gjithashtu gjykata veren se djali i tij Alban Sherbet Arapi eshte regjistruar prane QKR ne daten 18.03.2010, me NIPT L03918402N si Person Fizik dhe ushtron aktivitetin e prodhimit dhe tregetimit te produkteve blektorale.

Ne aktivitetin e tij tregetar paditesi Sherbet Arapi eshte vete i siguruar ndersa ne aktivitetin tregetar te djalit te tij Alban Arapi eshte e siguruar bashkeshortja e tij Havshe Arapi dhe djali i tij Alban Arapi.

Gjate gjykimit u vertetua fakti se nga ana e pales paditese te gjitha pagesat e sigurimeve jane te bera sipas afateve te percaktuara nga Ministria e Financave.

Gjykata veren se ne daten 18.06.2014 kane ardhur prane subjektit te mesiperm inspektoret e Drejtorise Rajonale te Tatimeve Fier,dhe gjate ushtrimit te inspekimit kane konstatuar se i gjithe dokumentacioni ligjor ishte ne perputhje me legjislacionet ne fuqi.

Gjykata veren se nga ana e pales se paditur ne ate moment ne dyqanin e Sherbet Arapit ndodhej dhe bashkeshortja e tij Havushe Arapi per te cilen gjate gjyimit u vertetua fakti se nuk ka qene duke shitur ose duke kryer ndonje pune prane dyqanit te paditesit,njekohesisht ne dyqan ka qene dhe vete paitesi Sherbet Arapi . Gjykata veren se nga ana e pales se paditur eshte mbajtur Akt Konstatimin me nr serie 0422484 date 18.06.2014, nga inspektoret tatimor ,ku theksohet se Subjekti Sherbet Arapi eshte ne zbatim te ligjit tatimor,perdor kase fiskale dhe mban dokumentacionin ne fuqi.

Ne pune u gjet Sherbet Arapi dhe bashke me te ne ambientet e dyqanit u gjet dhe znj, Havushe Arapi, bashkeshortja e tij.

Gjykata veren se nga ana e pales se paditur per faktin qe ne dyqan eshte gjendur edhe bashkeshortja e z. Sherbet Arapi ka perbere shkelje dhe per kete arsye eshte nxjerre Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore nr.12213 prot date 20.08.2014, ku gjobitet me 250.000 lek gjobe.

Gjykata veren se pala e paditur ne lidhje me kete fakt ka bere apelim prane Drejtorise se Apelimit Tirane,te cilet pas shqyrtimit te dokumentacionit kane vendosur "Lenien ne Fuqi te detyrimeve ne shumen 250.000 leke, percaktuar ne aktin administrativ Njoftim Vlersimi te detyrimeve tatimore nr 12213 prot date 20.08.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier per mosdeklarim te nje punonjesi ne organin tatimor.

Gjykata cmon se ky vendim eshte marre duke mos shqyrutar asnje dokumentacion te subjektit perkates ose duke mos pasur asnje prove ne lidhje me mosdeklarimin e nje punonjesi prane organeve tatimore.

Gjate gjykimit nga ana e pales paditese u vertetua fakti se subjekti "Sherbet Arapi e ushtron qe prej vitit 2003 aktivitetin dhe asnjehere nuk ka qene ne kundershtrim me procedurat dhe ligjet tatimore. Asnjehere me pare nuk ka marre nje gjobe ne ushtrimin e funksionit te tij nga ana e drejtorise tatimore. Pala paditese rezulton se ka te punesuar 1 punonjes i cili eshte deklaruar prane organeve kompetente.Gjithashtu bashkeshortja e tij ka qene e siguruar dhe e deklaruar ne biznesin e djalit te tij Alban Arapi,kjo vertetohet me deklarata E-SIG 025 ku vertetohet se znj.Havushe Arapi eshte e punesuar prane subjektit Fizik Alban Arapi si punonjese ferme e kualifikuar per baxho.

Gjithashtu gjate gjykimit u vertetua fakti se ne Akt Konstatimin e inspektoreve tatimor nuk eshte vertetuar se znj.Havushe Arapi ka qene duke punuar ne dyqanin e bashkeshortit te saj Sherbet Arapi.

Gjykata bazuar ne provat e mesiperme cmon se duhet te vendose per pranimin e kerkesepadise si te bazuar ne prova dhe ne ligj si dhe anullimin e njoftim vleresimit per detyrimet tatimore nr 12213 prot date 20.08.2014 te nxjerre nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier, anullimin e vendimit nr 24141/1 date 11.11.2014 i Drejtorise se Apelimit Tatimore prane Drejtorise se pergjitheshme te Tatimeve Tirane.

Konform nenit 45 te ligjit nr. 49/2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative " ndaj ketij vendimi nuk lejohet ankim, prandaj ai merr forme te prere.

Per Keto Aresye

Gjykata bazuar ne Ligjin nr. 49/2012 date 03/05/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative", nenet 32/a, 324/a i K.Pr.Civile; nenin 118/1 i K.Pr.Administrative, nenin 109/2, 123/c i Ligjit nr. 9920, date 19/05/2008 "Per procedurat tatimore ne RSH" I ndryshuar, Udhezimi Nr.24, date 02/09/2008 "Per procedurat tatimore ne RSH".

VENDOSI

1. Pranimin e kerkesepadise si te bazuar ne prova dhe ne ligj.
2. Anullimin e njoftim vleresimit per detyrimet tatimore nr 12213 prot date 20.08.2014 te nxjerre nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier.
3. Anullimin e vendimit nr 24141/1 date 11.11.2014 i Drejtorise se Apelimit Tatimore prane Drejtorise se pergjitheshme te Tatimeve Tirane.
4. Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales se paditur
5. Ky vendim eshte i formes se prere dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
6. Ndaj ketij vendimi nuk nxirret urdher ekzekutimi.
7. Ky vendim eshte i ekzekutueshem nga zyra e permbarimit gjyqesor menjehere.

U shpall ne Vlore, sot me dt.13.02.2015.

SEKRETARE
KAMILA PETRITI

GJYQTAR
KENDHIMA